



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/B00 / 10-1241
13.11.2018

PËR / ZA / TO	Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj	DATE DATUM DATE	13.11.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Faton Topalli, deputet i GP të PSD-së.		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Pyetja Parlamentare

I nderuar z. Kryeminister,

Në fillim të mandatit tuaj, keni deklaruar që do të ndalni vizitat zyrtare për punë të Komisioneve jashtë vendit. Në të shumtën e rasteve vizitat zyrtare kthehen në vizita turistike.

Andaj pyetja ime z.Kryeministër është:

Cilat janë arsyet që keni tërhequr këtë vendim?



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - R.E.P.L. - R.K.O.S.O.V.
KUVENDI I REPI - PRISTINA - PRISTINA
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

No. Erit. / No. Prist. / Prist. No. 06/2469/D₀-1304

Data / Datum / Date 06.12.2018

PRISTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Punëve të Brendshme z. Ekrem Mustafa</i>	DATE DATUM DATE	06.12.2018
NGA / OD / FROM	<i>Deputeti Andin Hoti</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Muajin e kaluar kam zhvilluar një takim me mbi 100 nxënës të shkollave të mesme të komunës së Prizrenit për të diskutuar problemin e përdorimit të drogës. Nxënësit janë të shqetësuar jo vetëm me rritjen e numrit të përdoruesve të drogës dhe qasjen shumë të lehtë madje edhe në drogat më të rënda, por edhe me faktin se në mesin e përdoruesve të drogës tani ka edhe nxënës të klasave të ulëta. Këtë fakt e konfirmon edhe raporti i Avokatit të Popullit, ku theksohet se moshja mesatare e përdoruesve të drogës ka rënë në moshën 16 vjeçare. Këto të dhëna janë alarmante dhe institucionet e shtetit duhet të trajtojnë me shumë seriozitet këtë çështje.

Problemi i përdorimit të drogës nga të rinjtë është problem shumë kompleks dhe nuk kufizohet vetëm në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të drogës, por edhe rehabilitimin e të rinjve që tashmë kanë rënë në grackën e drogës. Sot këta të rinj kanë vetëm një adresë në institucionet e shtetit, e që është Klinika e Psikiatrisë në QKUK përkatësisht Reparti i Sëmundjeve të Varësisë, ku shërimi dhe trajtimi i tyre duhet të zhvendoset në një departament të veçantë i dedikuar vetëm për fëmijë dhe adoleshentë që janë përdorues të drogave.

PYETJE :

I nderuari Ministër:

Duke qënë i vetëdijshëm që adresimi i këtij problemi kërkon angazhim të shumë institucioneve nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe aparatit të sigurisë, po kërkoj nga ju si Ministër i Punëve të Brendshme të na njoftoni se çfarë masa janë ndërmarrë deri tani dhe cilat janë strategjitë, politikat dhe projektet konkrete për luftimin e kësaj dukurie ?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
06/2553/No 1330
21.12.2018
PRISTINA

PËR / ZA / TO	<i>Ministrinë për Punë të Brendshme, z. Ekrem Mustafa</i>	DATE DATUM DATE	21.12.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Deputetja: Safete Hadergjonaj <i>Hadergjonaj</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika(2) e Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Kohëve të fundit në gjithë Kosovën është shpeshtuar dukuria e vjedhjeve nëpër shtëpia ku po rrezikohen familjarët dhe po shkaktojnë frikë, panik e shqetësim për të gjithë e në veçanti të fëmijët. Me qindra familje janë në panik se mos hajnat do të kthehen prapë në shtëpitë e tyre. Dukuria e grabitjes nga njerëz të maskuar e me armë është shpeshtuar nëpër biznese të ndryshme, me ç'rast po rrezikohet edhe jeta e punëtorëve dhe njerëzve të cilët gjenden brenda lokaleve.

PYETJE: Zoti Ministër, çka keni ndërmarrë në drejtim të parandalimit të kësaj dukurie, që familjarët të jenë të qetë në familjet e tyre, fëmijët të ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre si dhe bizneset të kenë sigurinë në kryerjen e veprimtarisë së tyre?



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS / SKUPŠTINA REPUBLIKËS SË KOSOVOVA / ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zëvendës Kryeministër dhe Parapresidenti i Kuvendit / Zëvendës Kryeministër dhe Parapresidenti i Kuvendit
Nr. Prot. / No. Prot. / Prot. No. 06/2686/16-1355
Data / Datum / Date 16.01.2019
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj	DATE / DATUM / DATE	16/01/2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Mimoza Kusari – Lila, Deputete e Alternativës		
SUBJEKTI / PREDMET / SUBJECT	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 31 Janar dhe 1 Shkurt, 2018 ka mbajtur seancën e jashtëzakonshme për gjendjen alarmante të cilësisë së ajrit. Kjo rezolutë ishte një masë shtesë, pas vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe komunës së Prishtinës për ndalimin e qarkullimit të Automjeteve për disa ditë në rrugët e Prishtinës. Nga kjo seancë e jashtëzakonshme, në harmonizim me të gjitha grupet Parlamentare, është nxjerrë një rezolutë e cila ka paraparë 18 pika për zbatim nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës:

Pyetje:

1. Kryeministër, një vit pas dhe situata në Kosovë e në veçanti në Prishtinë është në të njëjtët parametra alarmante. Cilat nga 18 pika të rezolutës i ka ndërmarrë apo plotësuar Qeveria juaj, duke e marrë parasysh se disa pika kanë pasur afat gjashtë mujor dhe 1 vjeçar për zbatim?
2. A janë ndërruar elektrofiltrat e KEK-ut në vitin 2018 sipas kërkesës në Rezolutë?
3. A është rishikuar dhe plotësuar me masa shtesë nga Qeveria juaj, Strategjia nacionale për mbrojtjen e mjedisit brenda gjashtë muorit të parë të 2018?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOSOVAN REPUBLIC OF KOSOVO
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përshkrime: Kancelaria për Fardige e Përcaktimje-Table Office

Nr. Prot. /
Bl. Prot. /
Prot. No: 06/2719/00-1378

Nr. i ffaqeve /
Broj stranica /
No. pages: 25.01.2019

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj	DATE DATUM DATE	25.01.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Sami Kurteshi- deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Mbyllja ose shuarja e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë.

PYETJA

I nderuar z, Kryeministër

A jeni Ju në dijeni për vendimin për mbylljen e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë?

Ky Institut është krijuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës në pjesën e parë të vitit 2011, në muajin Prill. Pas gati 7 vjet e gjysmë ekzistence, Qeveria e Kosovës e mbyll këtë institut për të krijuar një të ashtuquajtur “Departament për Drejtësi Tranzicionale”

Qëllimet e këtyre dy institucioneve ndryshojnë rrënjësisht.

Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës kishte për mandat “të analizojë dhe verifikojë krimet dhe ngjarjet e tjera të rëndësishme me qëllim të zhvillimit të një baze të të dhënave, shënimeve dhe rasteve për ndjekje penale të cilat pastaj mund të shfrytëzohen nga institucione të tjera të specializuara.”


Departamenti për Drejtësi Tranzicionale, sipas zyrtarëve të MD po krijohet me idenë që “të plotësojë tri çështje: Për ta vendosur në binarë të shëndoshë me një burokraci funksionale; të ndërtohet një databazë që do të ketë kredibilitet të institucional dhe do t’i shërbejë të gjitha organeve të drejtësisë.”

Cili është qëllimi final i këtij veprimi të Qeverisë?

A ka ky veprim të bëjë me manipulimet politike të Hashim Thaçit, i cili, tani e 10 vjet e ka kapur për fyti tërë sistemin e drejtësisë dhe të sigurisë në Kosovë, sidomos ministrinë e drejtësisë, dhe manipulon politikisht me tema siç janë krimet e luftës në Kosovë, të shkaktuara nga regjimet shoviniste antishqiptare serbe në vazhdimësi, me theks të veçantë në luftën e fundit.

Ky Institut është bojkotuar qëllimisht në mënyrat më të ndryshme, të hapura e të fshehta. E pakuptueshme për mendjen dhe logjikën shëndoshë njerëzore. Në vend se pikërisht ky institucion të forcohet, të konsolidohet dhe të funksionalizohet për të kryer punën në mënyrë efektive, për të mbledhur në mënyrë shkencore dhe institucionale dëshmitë e krimeve të Luftës në Kosovë, ky institucion mbyllet?! Sidomos në kohën kur trumbetohet se çështja e krimeve të Luftës në Kosovë dhe pasojat e saj do të jenë ndër temat kresore në të ashtuquajturin “Dialog me Serbinë”.

Pra, nëse jeni i informuar, cila është arsyeja e vërtetë e kësaj loje institucionale? Është e natyrës financiare, ligjore, politike apo, është lojë e rrezikshme dhe e paskrupullt politike për qëllime personale?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR/ZA/TO	<i>Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj</i>	DATE DATUM DATE	25.01.2019
		Reference	
NGA/OD/FROM	Sami Kurteshi- deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		<i>Sami Kurteshi</i>
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Çështja e hapjes së vendkalimit kufitar ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, në aksin rrugor Gjilan-Kumanovë, në pikën kufitare Stanaj-Bellanoc.

PYETJA

I nderuar z. Kryeministër

Para 6 muajsh e kam bërë të njëjtën pyetje. Në atë kohë, për shkak të hierarkisë së funksionit apo rëndësisë të çështjes së shtruar, nuk e di pse, në pyetje është përgjegjur Zv. Kryeministri E. Hoxhaj. Përgjigja doli të jetë e pavërtetë apo një përpjekje mashtrimi, sepse atëherë z. Hoxhaj deklaroi se ky vendkalim kufitar është i hapur dhe në funksion. Edhe krypometri ndërkombëtar e nxori si gënjeshtër.

Me sa di unë, aktualisht ka kontejnerë të cilët e mundësojnë kalimin në Stançiq - Bellanoc dhe këta kontejnerë u shërbejnë qytetarëve të Kosovës, që kurdo që ka lëvizje të lirë kjo të ndodhë. Por përtej kësaj, para 5-6 javësh ne kemi vendosur gurëthemelin e një pike të përbashkët kufitare e cila do të jetë pikë kufitare e kategorisë A dhe e cila do të ndërtohet brenda një afati të shkurtë kohor (23 korrik 2018, TRANSKRIPT, I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23, 26 DHE 30 KORRIK 2018)

Tani pyetjen po ua drejtoj juve, sepse siç duket në hierarkinë më të ulët, prej zv.Kryeministër e më poshtë ose nuk dijnë, ose nuk janë të informuar, ose qëllimisht dezinformojnë apo gënjejnë, këtë nuk e merr vesh njeri.

Midis Gjilanit dhe Kumanovës, nëpër grykën e Karadakut të Gjilanit, tanimë ekziston infrastruktura rrugore solide, madje shumë e mirë në pjesën maqedonase, sepse është ndërtuar para mbi 1 viti. Kjo rrugë që tani është përshtatshme për qarkullim të papengueshën për të gjitha llojet e automjeteve. Në pjesën e Kosovës, përveç disa përmirësimeve të pakta, që sigurisht duhet dhe mund të bëhen me shumë pak mjete dhe brenda një periudhe të shkurtë kohore, lehtësisht mund të përshtatet edhe për automjete gjysmë të rënda, deri në 10-15 tonelata.


Largësia midis Gjilanit dhe Kumanovës, si dy qendra kryesore të rajonit, është më e shkurtër se 40 kilometra. Ndërtimi i një vendkalimi kufitar zyrtar me Republikën e Maqedonisë në vendkalimin tani të përdorur nga banorët lokal të zonës në Stanaj (Stançiq) – Bellanoc do të lehtësonte dukshëm komunikimin dhe lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, me kursime jashtëzakonisht të mëdha të kohës dhe mjeteve për së paku 200-300'000 banorë të disa komunave; do të ndihmonte sado-kudo zhvillimin ekonomik të zonës në fjalë, sidomos turizmin; dhe njëkohësisht do të ndalonte dukshëm, shpopullimin e zonës.

Pyetja: A planifikon Qeveria e Kosovës hapjen e vendkalimit kufitar Stanaj-Bellanoc, në bashkëpunim me qeverinë maqedonase? Nëse jo, cilat janë problemet dhe pengesat objektive apo subjektive? Nëse po, kur planifikohet një veprim i tillë? Përfundimisht, nëse po, kur mund të shpresojnë banorët e zonës se mund të kalojnë këtë vendkalim kufitar në mënyrë zyrtare?

Falemnderit për bashkëpunimin!

Samir Kurteshi

Deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Ekrem Mustafa, Ministër i Punëve të Brendshme	DATE DATUM DATE	25.01.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Fatmire Mulhaxha Kollçaku, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHITJA: Prishja e rendit dhe qetësisë publike

Me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, Ligji për rendin dhe qetësinë publike parasheh gjoba për kundërvajtjet kundër prishjes së rendit dhe qetësisë publike.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, përgjegjëse është Ministria e Punëve të Brendshme.

Në rrugën “Rexhep Luci”, në Prishtinë, vite me radhë, banorët e lagjes terrorizohen në orët e vona të natës nga zhurma e padurueshme e shkaktuar nga lokalet të cilat punojnë pas orarit të lejuar (e që në sezonën e dimrit do të duhej të mbylleshin në ora 23, ndërsa gjatë verës t’iu lejohej puna vetëm deri në orën 24).

Përkundër faktit që banorët pothuajse çdo natë i telefonojnë zyrtarët e policisë, të cilët kohë pas kohe përgjigjen dhe intervenojnë aty për aty, nuk ka pasuar asnjë veprim konkret as nga Ministria

juaj e as nga ana e Inspektoratit Komunal, për shqiptimin e gjobave konform dispozitave të këtij Ligji, apo sipas rregullores së komunës për mosrespektim të orarit të punës.

Nga pronarët arrogantë të lokaleve, banorët e pakënaqur janë udhëzuar që t'i shesin banesat!!

PYETJE PARLAMENTARE

Ministër,

Pse nuk po zbatohet Ligji për rendin dhe qetësinë publike nga ana juaj? Pse nuk ka bashkëpunim me Inspektoratin e Komunës për zbatimin e Rregullores së Komunës që e rregullon orarin e punës së lokaleve në qendër të qytetit?

Fatmire Kollçaku

Deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES
SKUPSTINA REPUBLIC OF KOSOVO
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi i Propozimeve - Kancelaria e Drejtësisë - Prerredhja e Tabllës Ortive
Nr. Prot. 06/2729/No-1387
Pr. Prot. 28-01-2019
Prot. No. 28-01-2019
KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES
SKUPSTINA REPUBLIC OF KOSOVO
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO

PËR / ZA / TO	z. Abelard Tahiri, Ministri i Drejtësisë	DATE DATUM DATE	28.01.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Albulena Haxhiu - deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJEL		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHITJA

Më datën 4 korrik të vitit 2018, rreth 2000 punonjës të administratës së gjyqësorit dhe prokurorisë, patën hyrë në grevë.

Disa nga kërkesat e grevistëve ishin, ngritja e pagave, rregullimi i statusit të tyre si dhe përvoja e punës.

Më datë 11 korrik, përfaqësuesit e sindikatës së punëtorëve të judikaturës zhvilluan takime me ju si Ministër i Drejtësisë, kryesuesin e KGJK, z.Nehat Idrizi dhe kryesuesin e KPK, z.Blerim Isufaj.

Pas 8 ditësh, ata ndërprejnë greven, për shkak të zotimeve tuaja që do t'i merrni parasysh kërkesat e tyre.

PYETJA

Çka keni bërë në drejtim të realizimit të kërkesave të punënonjësve të administratës së institucioneve të drejtësisë?